



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:018949

Datë: 19.07.2024

Numri i dokumentit: 05960089

C-IV-14-4093

Ankuesi

Sh J nga f.sh Ll e P K.Podujevë
Përfaqësuar nga av. B I, Prishtinë

Kundër

E paditura

N.SH “FAN Zahir Pajaziti”, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, lagja Lakërishte- rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc. Murat Hulaj, me dt.17 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN046-0456 dt.15 prill 2014.
- II. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **Sh J** në emër të kompensimit për tri pagave të pa paguar t’i paguaj shumën prej **660.00€**, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore ti paguaj shumën **66.00€**.
- III.** Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- IV. OBLIGOHET** e paditura AKP, që përfaqësuesit të ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej **124.00€**.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.15 maj 2014, përfaqësuesi i ankuesit av. B I ka dorëzuar ankesën për shqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) nr. PRN046-0456 dt.15 prill 2014 për tri paga të pa paguara në shumë prej 660.00€ të NSH FAN “Zahir Pajaziti”. Në ankesën e tij thekson se të

gjithë punëtorët ishin pre e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga ndërmarrja dhe rrjedhimisht të gjithë kanë të drejtë në kompensim për paga të pa paguara. AKP nuk ua kishte mohuar këtë, por AKP ua ka refuzuar kërkesat e tyre duke pretenduar se këto kërkesa për kompensim janë të parashkuara. Përfaqësuesi konsideron se kërkesa e punëtorit nuk është parashkuara dhe se punëtorët e kësaj ndërmarrje kanë të drejtë në kompensim duke ju referuar ligjeve që janë në fuqi në Kosovë. Së bashku me ankesën përfaqësuesi ka bashkëngjitur: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, kopjen e librezës së punës.

Me anë të parashtresës së dt.26 janar 2020, i autorizuari i ankuesit ka bërë precizimin e kërkesës, duke i kërkuar tri paga të pa paguara në shumë prej 660.00€, me kamat prej 10%, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Me dt.02 dhjetor 2021, e paditura AKP parashtrroi mbrojtje në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të drejtë të dispozitave ligjore. E paditura pohoi se ankesa është e pa pranueshme pasi që konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekti i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria. Në këtë kontekst 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimet se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur të Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL-ja me marrjen e vendimit. Argumenti tjetër në përgjigjen e parashtruar të AKP-së është se pretendimet e parashtruesit për kompensim për paga të pa paguara si dhe tri paga të pa paguara janë të parashkuara. Në varësi të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda 3 vjetësh nga koha kur parashtruesi ka fituar të drejtën të kërkojë kompensim. Në fund e paditura AKP propozon gjykatën që ankesa të refuzohet si e pa pranueshme dhe pa bazuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohen vendimet e kundërshtuara të AL-së.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e

tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjenden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjenden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për tri pagat e papaguara të kërkuara në këtë lëndë, si dhe për paga të pa paguara ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Fan Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për tri paga të pa paguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në provat e paraqitura në gjykatë si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga Lista e rrogave të mbetura borxh të dt.31.03.2006, vërtetohet fakti se ankuesi kishte paga të papaguara nga NSH në shumë prej 1.135.27€.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara listë pagesën vjetore të pagave të dt.31.03.2006, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH-në dhe se NSH i ka mbetur borxh pagat, po ashtu ankuesit i takojnë dhe tri paga të pa paguara. E paditura

nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listë pagesën vjetore të pagave lëshuar nga personi përgjegjës i NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 660.00€, gjykata është bazuar në listë pagesën e pagave të dt.31.03.2006, e cila është e nënshkruar nga Drejtori financiar Sh M, si dhe nga Drejtori N L. Gjithsejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 660.00€, ashtu siç kishte kërkuar ankuesi me ankesë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Po ashtu, gjykata vlerëson se në bazë të librezës së punës vërtetohet se ankuesi kishte ofruar shërbime për NSH-në nga dt.08.05.1972 deri me dt.31.12.2011.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi Sh J, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për tri paga, në shumën e aprovuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

OBLIGOHET e paditura AKP, që përfaqësuesit të ankuesit t'ia paguaj shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës në shumën prej **124.00€** ashtu që për hartimin e padisë në shumë prej 104.€, si dhe kompensimin e shumës për taksa gjyqësore në vlerë prej 20.€ për padi.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Dr. Sc. Murat Hulaj- gjyqtar,
